VENDIM
Nr.255, datë 27.4.2006

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2006, MIRATUAR PËR MINISTRINË E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT, PËR EMERGJENCËN VETERINARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të nenit 12 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006" dhe të nenit 61 të ligjit nr.9308, datë 4.11.2004 "Për shërbimin dhe inspektoratin veterinar", me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në buxhetin e miratuar për vitin 2006, zëri "emergjenca veterinare", t'i shtohet fondi prej 10 000 000 (dhjetë milionë) lekësh për emergjencën veterinare, kontrollin, parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve infektive, me karakter tepër përhapës e dëmtues te kafshët.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave dhe t'i rikthehet në çastin e rimbursimit të këtij fondi nga donatorët e huaj.
3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha